



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 43/1 prot.

Tiranë, më 04. 02. 2020

**V E N D I M**

**Nr. 16, Datë 04. 02. 2020**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 98, datë 09.08.2019, e shtetases M. M., kundër Ministrisë Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në vijim MASR), Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrës Vendore Arsimore Dibër (në vijim ZVA Dibër) në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak se më datë 26.04.2019, ka kundërshtuar Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Besa Shahini, lidhur me vendimin e mbylljes së Shkollës “Said Najdeni”*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Ankuesja shpjegon se më datë 23.08.1998, ka filluar punë pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Dibër (në vijim DAR Dibër), në pozicionin Specialiste e Sektorit të Kontrollit dhe Kualifikimit. Më datë 31.08.2004, është transferuar në pozicionin e Juristes në Sektorin e Programeve të Zhvillimit. Gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e juristes, për nevoja të DAR Dibër, ankuesja është ngarkuar nga eprorët me detyra të shtesë, duke mbajtur pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të Programeve të Zhvillimit, për një periudhë të përkohshme. Me shkresën Nr. 2444/7 prot., datë 16.03.2017, ankueses i është ngarkuar detyra e Drejtorit të DAR Dibër. Më datë 01.11.2018, ankuesja është vënë në dijeni nga Prefekti i Qarkut Dibër, lidhur me Urdhërin Nr. 725, datë 30.10.2018 të MASR, për shkarkimin nga detyra të saj dhe emërimin e drejtuesit të ri të DAR Dibër.

Duke pranuar si vullnet të MASR, ankuesja ka lënë detyrën e drejtorit të DAR Dibër dhe ka vijuar të ushtronte sërish detyrën e mëparshme të Juristes.

Më datë 26.04.2019, ankuesja në një takim me Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në shkollën “Said Najdeni”, ka kundërshtuar vendimin e MASR për bashkimin e gjimnazit “Said Najdeni 1” dhe “Said Najdeni 2”, duke e konsideruar atë si një vendim të padrejtë dhe në dëm të nxënësve të qytetit të Peshkopisë. Pak ditë pas debatit të zhvilluar mes saj dhe Ministres së MASR, më datë 30.04.2019, ankuesja është vënë në dijeni se ndaj saj ka nisur procedim disiplinor dhe është marrë vendimi për pezullimin nga detyra. Më pas me shkresën Nr. 5150/3 prot., datë 14.05.2019, është vënë në dijeni vendimi për largimin nga shërbimi civil për shkak të ristrukurimit.

Në kuadër të ristrukurimit në shkallë kombëtare të Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore, me shkresën Nr. 3559/1 prot., datë 28.06.2019, ankuesja është njoftuar nga MASR për fillimin e procesit të riorganizimit të DAR Dibër dhe për faktin se ajo është objekt i gjykimit për transferim apo përfundim të marrëdhënieve të punës në shërbimin civil.

Sipas ankueses, një ditë pas largimit të saj nga detyra, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, ka nxjerrë disa urdhëra ku ish punonjës të DAR Dibër, janë emëruar në ZVA Dibër. Në këtë kuptim, ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë në raport me punonjësit e tjerë të DAR Dibër.

Ankuesja sqaron se largimi i saj nga puna dhe mos konfirmimi në pozicionin e juristes në DAR Dibër, ka ardhur për shkak të debatit të zhvilluar ndërmjet saj dhe Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë më datë 26.04.2019.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- konstatimin e diskriminimit në marrëdhëniet e punës,
- marrjen e masave nga punëdhënësi për rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barasvlefshëm me të.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së<sup>1</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës Nr. 98, datë 09.08.2019, të M. M. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me anë të shkresës Nr. 1221/2 prot., datë 26.08.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar subjekteve, ku i ka kërkuar informacion lidhur me pretendimet për diskriminim, të subjektit ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me anë të shkresës<sup>2</sup> Nr. 2308 prot., datë 16.09.2019, vuri në dispozicion të KMD-së informacion lidhur me pretendimet e palës ankuese, duke sqaruar ndër të tjera se: “...Në zbatim të VKM nr. 99, datë 27.02.2019 ‘Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore rajonale dhe Zyrat Arsimore’, është krijuar Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucion i cili përfshin tërësinë e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë integrale e sistemit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm arsimor. Vendimi Nr. 66, datë 03.02.2010 i KM ‘Për organizimin e drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore’, i ndryshuar, është shfuqizuar. Në këtë kuptim përfundojnë marrëdhëniet juridike të punës së nëpunësve të DAR/ZA-ve në shërbimin civil. Mbyllja dhe ristrukturimi i DAR/ZA-ve është bërë në kuadër të riorganizimit të institucioneve të reja arsimore si Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar ku marrëdhëniet e punës në zbatim të pikës 13, të Kreut III, të VKM nr. 99, datë 27.02.2019 ‘Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë

<sup>1</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

<sup>2</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1221/3 prot., datë 19.09.2019

*Arsimore rajonale dhe Zyrat Arsimore*, rregullohen në bazë të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 'Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar. Bazuar në VKM-në e sipërcituar, funksionet e DAR/ZA-ve përthithen në institucionet e reja arsimore të krijuara. Në lidhje me ristrukturimin, në kuadër të VKM-së Nr. 99, datë 27.02.2019 'Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore rajonale dhe Zyrat Arsimore', Urdhërit Nr. 68, datë 05.04.2019, të Kryeministrit 'Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar', si dhe të Urdhërit Nr. 234, datë 19.04.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë 'Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar', Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore i janë nënshtruar procesit të ristrukturimit për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit. Në pikën 6, të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 'Për nëpunësin civil', i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se përfundimi i marrëdhënieve të punës në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, lejohet vetëm në rastin kur si pasojë e këtyre procedurave, ka shkurtim të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civil. Sqarojmë se si pasojë e mbylljes së Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore, ka një shkurtim të numrit të përgjithshëm prej 496 nëpunësish civil. Me Urdhërin Nr. 29, datë 25.04.2019, të Departamentit të Administratës Publike është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, në MASR i cili në kuptim të neneve 22, e vijues të ligjit nr. 44/2015 'Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë', nenit 3, pika 3 të ligjit nr. 152/2013 'Për nëpunësin civil', i ndryshuar, si dhe Kreut II të VKM nr. 125, datë 17.02.2016 'Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil', është organ kompetent për zhvillimin e procedurës administrative me qëllim përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të nëpunësve që punojnë pranë institucioneve të ristrukturuara/mbyllura, përkatësisht Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore. Një nga të drejtat që parashikon neni 50, i ligjit nr. 152/2013 'Për nëpunësin civil', i ndryshuar, për nëpunësit që lirohen nga shërbimi civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit është dhënia e një dëmshpërblimi në raport me vitet e punës në shërbimin civil. Gjithashtu në këtë nen parashikohet edhe e drejta e ruajtjes së statusit të nëpunësit civil për një periudhë 2 vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit civil të cilët janë larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e ristrukturimit apo mbylljes së institucionit. Këta nëpunës civil mund të konkurojnë në procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë për ato pozicione ku sipas rastit plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të pozicionit vakant të shpallur. Përsa më sipër, bazuar në shkronjën 'b' të pikës 17, të Kreut II, të VKM-së nr. 125, datë 17.02.2016 'Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil', Komisioni i Ristrukturimit, vendosi përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil, për M. M.. Aktet administrative të Komisionit të Ristrukturimit gjendjen në MASR, si dhe sqarojmë se këto akte janë dërguar individualisht çdo nëpunësi civil në DAR/ZA. Emërimet dhe lirimet e punonjësve të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), bazuar në Kreun III, pika 14 e vendimit nr. 99, datë 27.02.2019 'Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së

*Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore rajonale dhe Zyrat Arsimore'. Përsa më sipër, ankuesja nuk është emëruar specialiste në ZVA Dibër, pasi ka qënë në një procedurë disiplinore në vijim nga ana e Departamentit të Administratës Publike. Nga ana e DPAP në rekrutimin e stafeve të DRAP dhe ZVA-ve është mbajtur në konsideratë sistemimi i të gjithë punonjësve të DAR/ZA-ve të cilët ishin në sistem në momentin e ristrukturimit duke u kujdesur për të mos bërë emëtime të punonjësve që kanë pasur masa disiplinore pa përfunduar më parë procedura disiplinore. Konkretisht me vendimin nr. 17, datë 30.04.2019, ndaj ankueses është marrë masa e pezullimit nga detyra nga komisioni i disiplinës i ngritur në DAR Dibër, fakt që na ka penguar të bëjmë emërimin e ankueses në një nga pozicionet e lira të ZVA Dibër. Sqarojmë se të gjitha emërimet e punonjësve në institucionet e reja të krijuara DPAP/DRAP dhe ZVA janë me kontratë të përkohshme deri në përfundim të procedurave të konkurimit. Me hapjen e procedurave të konkurimit ankuesja mund të konkurojë për pozicionet që do të dëshirojë si DPAP/DRAP dhe ZVA sipas profilit të punës dhe diplomës që disponon. Në lidhje me informacionin e kërkuar nëse ka patur punonjës të tjerë të ish DAR Dibër që nuk janë emëruar, ju sqarojmë se ka pasur të tjerë të cilët nuk janë emëruar në strukturat e reja të krijuara, të cilët janë si më poshtë vijon: F. E., M. D., G. M. dhe M. Markja. Në lidhje me informacionin e kërkuar nëse ka patur punonjës të ish DAR Dibër që janë emëruar në punë në ZVA Dibër, ju sqarojmë se ka pasur punonjës që janë emëruar në strukturat e reja që janë krijuar. Të gjithë punonjësit e tjerë janë me status të nëpunësit civil janë përthithur në ZVAP. Në lidhje me informacionin e kërkuar për numrin e pozicioneve të punës në ZVA Dibër në të cilat kërkohet arsimi i lartë Jurist, ju sqarojmë se në Urdhërin Nr. 234, datë 19.04.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë 'Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar', është një pozicion Jurist. Në lidhje me informacionin e kërkuar për personin e emëruar në pozicionin e Juristit, ju sqarojmë se në ZVA Dibër, nuk ka jurist të emëruar. Në lidhje me informacionin e kërkuar për kriteret e vendosura, për lëvizjet e punonjësve të tjerë, gjatë riorganizimit të DAR Dibër në ZVA Dibër, janë mbajtur parasysht elementët e mëposhtëm: Vjetësia në punë; Vjetësia në Zyrën Arsimore Dibër dhe Vlerësimi i Titullarit”.*

Në përfundim të përgjigjes, është vënë në dispozicion të KMD-së:

- Shkresa Nr. 3600 prot., datë 07.04.2017 e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS.
- Urdhër Nr. 725, datë 30.10.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm të MAS.
- Vendimi Nr. 17, datë 30.04.2019 nga Komisioni i Disiplinës së DAR Dibër.
- Vendim për lirim të Shërbimi Civil i M. M..
- Organika e DAR sipas Udhërit të Kryeministrit Nr. 199, datë 01.12.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore”.
- Organika e ZVA Dibër sipas Urdhërit Nr. 234, datë 19.04.2019, të ministrit të MASR “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës Nr. 98, datë 09.08.2019, Komisioneri me shkresën Nr. 1221/4 prot., datë 21.10.2019, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 28.10.2019 duke kërkuar shpjegime shtesë.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse të MASR-së, me anë të shkresës<sup>3</sup> Nr. 9630/1 prot., datë 23.10.2019, informoi Komisionerin se: *"...Duke marrë në konsideratë faktin se dokumentacioni që ju kërkonti nuk ndodhet i gjithi pranë MASR, si edhe me qëllim që përfaqësuesit e MASR të përgatiten sa më mirë për trajtimin e kësaj çështje, do të kërkonim nga ana juaj shtyrjen e seancës dëgjimore në një datë tjetër"*.

Përsa më sipër, Komisioneri me anë të shkresës Nr. 1633 prot., datë 25.10.2019, njoftoi palët në proces për shtyrjen e seancës dëgjimore dhe realizimin e saj më datë **04.11.2019**.

Në përfundim të shkresës së sipërcituar, KMD ka kërkuar nga MASR, të vërë në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore, informacionin lidhur me:

- Kopje të Vendimit nr. 4980/59 prot., datë 08.05.2019, të Komisionit të Ristrukturimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Kopje të vlerësimeve të punës së M. M. të tre viteve të fundit.
- Kopje të dosjes personale të M. M.
- Informacion nëse ka persona të emëruar pas ndryshimeve të strukturës së DAR Dibër në ZVA Dibër. Nëse po, informacion në cilat pozicione janë emëruar dhe kopje të dokumentacionit lidhur me arsimin e tyre.
- Informacion lidhur me numrin e pozicioneve të punës në ZVA Dibër në të cilat kërkohet arsimi i lartë Jurist.
- Kriteret e vendosura, për lëvizjet e punonjësve, gjatë riorganizimit të DAR Dibër në ZVA Dibër.
- Informacion lidhur me ecurinë e procedimit disiplinor të ndërmarrë ndaj M. M.

Seanca u zhvillua në datën 04.11.2019, me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues, dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit<sup>4</sup> të MASR, z. A. K., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

<sup>3</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1630 prot., datë 24.10.2019

<sup>4</sup> Përfaqësuar me Autorizim Nr. 2193/1 prot., datë 19.08.2019, të Postës Shqiptare sh.a.



Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të rregjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Fillimisht ankuesja sqaroi ndër të tjera se gjatë ushtrimit të detyrës pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Dibër (në vijim DAR Dibër), ndaj saj nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Në periudhën Mars 2017-Nëntor 2018, ka ushtruar detyrën e Drejtorit të DAR Dibër dhe është njohur me disa ankesa të ardhura nga prindër e nxënës të gjimnazit “Said Najdeni”, të cilat lidheshin me numrin e lartë të nxënësve në klasë dhe ambjentet e pamjaftueshme për të përballuar këtë numër nxënësish. Në këto kushte, ajo i është drejtuar me shkresa Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në vijim MASR), duke përcjellë ankesat e komunitetit të prindërve dhe nxënësve të gjimnazit “Said Najdeni”. Gjithashtu në kushtet e mbylljes së Filialit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, në Peshkopi (në vijim UAMD), godina mbeti bosh. Në këtë situatë, ka kërkuar<sup>5</sup> nga ana e MASR shfrytëzimin e kësaj godine për gjimnazin “Said Najdeni”, duke vendosur një pjesë të stafit dhe nxënësve të kësaj shkolle në këto ambiente. Në vijim, referuar legjislacionit në fuqi dhe në bashkëpunim me institucionet vendore të qytetit të Peshkopisë dhe Këshillit të Prindërve, ka urdhëruar ndarjen e gjimnazit “Said Najdeni” në dy të tillë, në “Said Najdeni” Peshkopi 1 dhe “Said Najdeni” Peshkopi 2. Në këtë kuptim, u krijua një drejtori shkolle më vete dhe nxënësit u ndanë në dy godina, duke patur mundësi për zhvillimin e mësimi në kushte më të mira.

Në vijim ankuesja ka sqaruar se pas largimit të saj nga pozicioni i drejtores së DAR Dibër, në muajin Prill 2019, nga drejtuesja e re e këtij institucioni është urdhëruar mbyllja e shkollës “Said Najdeni” Peshkopi 2. Në këto kushte, ajo i është drejtuar Ministres së MASR dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MASR, me anë të e-mail zyrtar në dt. 09.04.2019, për të ndaluar këtë veprim, duke qënë se sipas saj, kjo ishte në dëm të nxënësve të gjimnazit “Said Najdeni” dhe komunitetit të qytetit të Peshkopisë. Ankuesja nuk mori asnjë përgjigje nga institucionet e mësipërme sa i takon kësaj problematike.

Më datë 26.04.2019, në ambjentet e gjimnazit “Said Najdeni”, Ministrja e MASR ka zhvilluar një takim me stafin e shkollës, ku ankuesja ka kundërshtuar vendimin e MASR për ribashkimin e gjimnazit “Said Najdeni” në një të vetëm, duke e konsideruar atë si një vendim të padrejtë dhe në dëm të nxënësve të qytetit të Peshkopisë. Në përgjigje të saj, Ministrja ka shprehur habinë se ku mund të ndodhë që një punonjës të kundërshtojë eprorin në këtë mënyrë. Më pas më datë 30.04.2019, ankuesja është vënë në dijeni se ndaj saj ka nisur procedim disiplinor dhe është marrë vendimi për pezullimin nga detyra, me arsyetimin e hapjes së një institucioni arsimor pa

---

<sup>5</sup> Me anë të shkresave Nr. 2661 prot., datë 13.12.2017; Nr. 618 prot., datë 11.04.2018; Nr. 2211 prot., datë 17.10.2018;

marrë miratimin e MASR-së. Sipas ankueses ky veprim lidhet drejtëpërdrejtë me situatën e ndodhur më datë 26.04.2019 dhe me asnjë arsye tjetër. Në vijim ankuesja është njohur me shkresën Nr. 5150/3 prot., datë 14.05.2019 vendim për largimin nga shërbimi civil për shkak të ristrukurimit. Në këto kushte ankuesja i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, për të marrë dijeni lidhur me arsyet e mos emërimit të përkohshëm në pozicionin e specialistit në DAR Dibër. Në përgjigje të saj, ajo sqaron se është vënë në dijeni nga ana e DPAP-së se pezullimi nga ana e Komisionit Disiplinor, ka penguar emërimin e saj në pozicionin e specialistit të ZVA Dibër (me strukturën e re). Sipas ankueses, dy nga personat që kanë marrë pjesë në Komisionin e ngritur për hapjen e shkollës “Said Najdeni” Peshkopi 2, kanë qënë edhe pjesë e Komisionit Disiplinor i cili e ka pezulluar atë nga detyra. Në këto kushte, ankuesja ngriti pretendimin se nuk ka qënë arsye e pezullimit hapja e shkollës, por shkak është bërë kundërshtimi i Ministres në takimin e datës 26.04.2019, pasi po të kishte qënë kjo arsye do të ishin ndërmarrë masa edhe ndaj anëtarëve të tjerë të komisionit dhe jo vetëm për të.

Në vijim ankuesja ka sqaruar se, Komisioni Disiplinor pavarësisht procedurave të nisura ndaj saj, nuk arriti asnjëherë të marrë një vendim dhe të konstatojë shkeljen disiplinore të pretenduar.

Në kundërshtim të argumentave të palës ankuese, përfaqësuesi i MASR theksoi faktin se Komisioni i Disiplinës nuk ka dalë me një vendim përfundimtar, pasi pengesë është bërë përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil të 4 anëtarëve të komisionit. Pra, sipas tij Ligji nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar parashikon që anëtarët e Komisionit Disiplinor duhet të mbajnë statusin e nëpunësit civil. Në kushtet që këta punonjës nuk e gëzojnë më këtë status, komisioni nuk kishte më legjitimitet për të vijuar me shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj M. M.. Pra, komisioni ka përfunduar së ekzistuari dhe nuk është shprehur me një vendim përfundimtar. Përsa i përket, moskonfirmimit në detyrë të M. M., përfaqësuesi i MASR theksoi faktin se shkak është bërë shkeljet e saj në hapjen e një shkolle të re “Said Najdeni 2” dhe jo debati që ka patur me Ministren e MASR. Sipas tij, një grup pune i MASR-së ka ushtruar kontroll në DAR Dibër dhe ndër të tjera ka konstatuar shkelje në këtë drejtori lidhur me hapjen disa shkollave të reja, si dhe shkollën “Said Najdeni 2”. Në përfundim, ky grup kontrolli ka kërkuar marrjen e masave ndaj punonjësve të cilët kanë kryer këto shkelje. Trajtimi i ankueses në krahasim me kolegët e rikonfirmuar në detyrë, është bërë në mënyrë të barabartë dhe nuk ka patur asnjë diferencim theksoi përfaqësuesi i MASR. Të gjithë punonjësit e DAR Dibër për shkak të ristrukurimit, iu nënshtruan procedurave të ristrukurimit dhe për këtë arsye u bë lajmërimi i tyre për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Si çdo punonjës tjetër edhe M. M. është njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Për një pjesë të punonjësve të ish-DAR Dibër dhe tani ZVA Dibër, është bërë emërimi i përkohshëm në detyrë, ndërsa për ankuesen nuk është bërë për shkak të shkeljeve të konstatuara dhe procedurën e nisur nga Komisioni Disiplinor.



- Mbështetur në informacionin e kërkuar<sup>6</sup> nga KMD gjatë seancës dëgjimore, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me shkresën<sup>7</sup> nr. 193 prot., datë 10.01.2020, vuri në dispozicion informacionin e kërkuar.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje objekt i ankesës dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative<sup>8</sup>, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të cilët duhet të provonin se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej saj.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre,*

<sup>6</sup> Me anë të e-maileve datë: 05.11.2019, 13.12.2019 dhe 09.01.2020,

<sup>7</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 43 prot., datë 10.01.2020

<sup>8</sup> Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

*përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD<sup>9</sup> në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Ankuesja ka filluar punë pranë DAR Dibër, fillimisht në pozicionin Inspektor, më datë 01.09.1998. Më pas nga viti 2004, ka ushtruar detyrën e Juristes pranë këtij institucioni, deri më datë 02.11.2015, kur është emëruar Përgjegjëse në Sektorin e Programeve të Zhvillimit. Më pas nga data 02.05.2016 deri më datë 16.03.2017 ka ushtruar sërish detyrën e Juristes së DAR Dibër. Më datë 16.03.2017, ankuesja është emëruar në pozicionin e Drejtorit të DAR Dibër, të cilin e ka ushtruar deri më datë 01.11.2018, kur është emëruar sërish në pozicionin e Juristes së institucionit.

Gjatë periudhës që ankuesja ka drejtuar DAR Dibër, është njohur me disa ankesa të ardhura nga prindër e nxënës të gjimnazit “Said Najdeni”, të cilat lidheshin me numrin e lartë të nxënësve në klasë dhe ambientet e pamjaftueshme për të përballuar këtë numër nxënësish. Në këto kushte, ajo i është drejtuar me shkresa Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në vijim MASR), duke përcjellë ankesat e komunitetit të prindërve dhe nxënësve të gjimnazit “Said Najdeni”. Gjithashtu, në kushtet e mbylljes së Filialit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, në Peshkopi (në vijim UAMD), godina e filialit mbeti bosh. Në këtë situatë, ka kërkuar<sup>10</sup> nga ana e MASR shfrytëzimin e kësaj godinë për gjimnazin “Said Najdeni”, duke vendosur një pjesë të stafit dhe nxënësve të kësaj shkolle në këto ambiente. Me Vendim Nr. 58, datë 12.10.2018, DAR Dibër ka ngritur Komisionin e vlerësimit të kërkesës për ndarjen e gjimnazit “Said Najdeni”, në dy drejtori. Në këtë komision bënë pjesë:

- **M. M., me detyrë Drejtore e DAR Dibër.**
- Z. Gj., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Zhvillimit, në DAR Dibër.
- **B. D., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë, në DAR Dibër.**
- **Sh. C., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme, në DAR Dibër.**

<sup>9</sup> Shkurtesë e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

<sup>10</sup> Me anë të shkresave Nr. 2661 prot., datë 13.12.2017; Nr. 618 prot., datë 11.04.2018; Nr. 2211 prot., datë 17.10.2018;

- K. D., me detyrë Drejtor i shkollës “Said Najdeni”.
- A. N., me detyrë Kryetar i Bordit të shkollës “Said Najdeni”.
- M. P., me detyrë Kryetar i Këshillit Rajonal të Prindërve.
- Përfaqësues të Bashkisë Dibër, Preferkturës Dibër, mësues dhe nxënës të shkollës “Said Najdeni”.

Në vijim, në bashkëpunim me institucionet vendore të qytetit të Peshkopisë (Bashkia, Prefekti etj.) dhe Këshillit të Prindërve, me urdhërin Nr. 138, datë 22.10.2018, DAR Dibër ka urdhëruar ndarjen e gjimnazit “Said Najdeni” në dy të tillë, në “Said Najdeni” Peshkopi 1 dhe “Said Najdeni” Peshkopi 2. Në këtë kuptim, u krijua një drejtori shkolle më vete dhe nxënësit u ndanë në dy godina.

Mbështetur në Urdhërin Nr. 152, datë 12.03.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR është ngritur një grup pune për verifikimin e ankesës së depozituar në MASR dhe në Platformën e Bashkëqeverisjes nga një shtetase, mësuese në gjimnazin “Said Najdeni”. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj ankese, grupi i punës ka ushtruar kontroll në DAR Dibër dhe ka konstatuar ndër të tjera se:

- Vendimi i marrë nga ana e DAR Dibër për ndarjen e gjimnazit “Said Najdeni” në dy drejtori më vete është në kundërshtim me ligjin. **Në këto kushte ka rekomanduar MASR-në të marrë masa për personat përgjegjës, të cilët kanë vendosur, nëpërmjet Vendimit Nr. 138, datë 22.10.2018 “Për ndarjen e gjimnazit ‘Said Najdeni’ në dy drejtori dhe funksionimin e gjimnazit ‘Said Najdeni 2’ me 1 drejtor dhe dy nëndrejtorë”.**
- MASR të marrë masën për “Shkarkim nga detyra” të Drejtorit të komanduar të DAR Dibër, A. H.
- Komisioni Disiplinor në MASR të fillojë ecurinë disiplinore për z. A. H., drejtor i komanduar i DAR Dibër.
- Etj.

Këtë raport, MASR e ka vënë në dispozicion të DAR Dibër, më datë 26.03.2019, me anë të shkresës Nr. 2952/2 prot., datë 26.03.2019.

Përsa më sipër, DAR Dibër ka filluar menjëherë zbatimin e tij fillimisht duke shkarkuar drejtorin e komanduar dhe duke emëruar znj. B. D, e cila më parë mbante detyrën e përgjegjëses së Sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë, në këtë institucion. Ndër të tjera DAR Dibër me urdhërin Nr. 35, datë 04.04.2019, urdhëroi anulimin e urdhërit Nr. 138, datë 22.10.2018 “Për ndarjen e gjimnazit ‘Said Najdeni’ në dy drejtori dhe funksionimin e gjimnazit ‘Said Najdeni 2’ me 1 drejtor dhe dy nëndrejtorë”. **Nga informacioni i administruar nga palët në proces, DAR Dibër nuk ndërmoi asnjë masë ndaj personave përgjegjës, të cilët kanë vendosur, nëpërmjet Urdhërit Nr. 138, datë 22.10.2018 “Për ndarjen e gjimnazit ‘Said Najdeni’ në dy**

***drejtori dhe funksionimin e gjimnazit ‘Said Najdeni 2’ me 1 drejtor dhe dy nëndrejtorë”, por bëri vetëm anulimin e urdhërit duke rikthyer gjimnazin në gjendjen e mëparshme.***

Gjatë periudhës që ankuesja ushtronte detyrën e Juristes më datë 26.04.2019, Ministria e MASR, ka zhvilluar një takim në shkollën “Said Najdeni”. Në këtë takim të mbajtur, rezulton që ankuesja të ketë qënë prezent dhe ka kundërshtuar urdhërin Nr. 35, datë 04.04.2019 të ZVA Dibër për bashkimin e gjimnazit “Said Najdeni 1” dhe “Said Najdeni 2”, duke e konsideruar atë si një vendim të padrejtë dhe në dëm të nxënësve të qytetit të Peshkopisë. Sipas informacionit të administruar, në përgjigje të ankueses, Ministrja është shprehur se nuk e di në cilin univers mund të ndodh që të protestojë punonjësi i Ministrisë kundër Ministres.

Më pas, me Urdhër Nr. 42, datë 30.04.2019, DAR Dibër ka ngritur Komisionin Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore për M. M. dhe po në të njëjtën ditë nga ana e këtij komisioni është vendosur pezullimi nga detyra i saj, me arsyetimin se gjatë kohës që ushtronte detyrën e Drejtorit të DAR Dibër ka urdhëruar pa marrë miratimin e MASR, për hapjen e shkollave:

- Gjimnazi “Said Najdeni 2” të krijohet si drejtori më vete i ndarë nga gjimnazi “Said Najdeni”, me Urdhër nr. 138, datë 22.10.2018 të DAR Dibër.
- Në bazë të Urdhërit nr. 134, datë 15.10.2018 “Për ndryshim statusi të shkollës 9-vjeçare Radomirë”, është ndryshuar statusi i shkollës 9 vjeçare Radomirë në Shkollë të Mesme të Bashkuar, por mungon e gjithë procedura për ndryshimin e statusit të kësaj shkolle.
- Në bazë të Urdhërit nr. 135, datë 15.10.2018 “Për ndryshim statusi të shkollës 9 vjeçare Selishtë”, është ndryshuar statusi i shkollës 9 vjeçare Selishtë, por mungon e gjithë procedura për ndryshimin e statusit të kësaj shkolle.
- Në bazë të Urdhërit nr. 111, datë 19.09.2018 “Për ndryshim statusi të shkollës 9 vjeçare Sine”, por mungon e gjithë procedura për ndryshimin e statusit të kësaj shkolle.
- Në DAR Dibër nuk ekziston një urdhër dhe asnjë lloj procedure për ndryshim statusi të shkollës 9 vjeçare “Tahir Losha” Lunare në Shkollë të Mesme të Bashkuar.

Gjithashtu, DAR Dibër me anë të shkresës Nr. 730 prot., datë 30.04.2019 ka njoftuar ankuesen lidhur me fillimin e ecurisë disiplinore të nisur ndaj saj. Më pas është njoftuar dy herë ankuesja për realizimin e një seance dëgjimore, por që nuk është zhvilluar asnjëherë. Lidhur me veprimet e mëtejshme të Komisionit Disiplinor, ankuesja nuk rezulton të jetë njohur me asnjë procedurë, pavarësisht kërkesave të saj.

Theksojmë se në seancën dëgjimore përfaqësuesi i MASR u shpreh: *Për një pjesë të punonjësve të ish-DAR Dibër dhe tani ZVA Dibër, është bërë emërimi i përkohshëm në detyrë, ndërsa për ankuesen nuk është bërë për shkak të shkeljeve të konstatuara dhe procedurën e nisur nga Komisioni Disiplinor. Ndërsa sa i takon Komisionit Disiplinor përfaqësuesi i MASR theksoi: Komisioni i Disiplinës nuk ka dalë me një vendim përfundimtar, pasi pengesë është bërë përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil të 4 anëtarëve të komisionit. Sa më sipër,*

Komisioneri konstaton se ankuesja nuk është njohur në asnjë moment me vendimin përfundimtar të Komisionit Disiplinor.

Në referim të Urdhërit Nr. 34, datë 04.04.2019 “Për ngritjen e komisionit për zbatim të rekomandimeve pranë DAR Dibër”, vërehet se në përbërje të tij janë:

- **B. D., me detyrë Drejtor i DAR Dibër.**
- D. C., me detyrë Specialist i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.
- **Sh. C., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme.**

Gjithashtu, po ti referohemi Urdhërit Nr. 42, datë 30.04.2019, të DAR Dibër, ngritur për Komisionin Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore për M. M., vërejmë se anëtarë të tij janë:

- **B. D., me detyrë Drejtor i DAR Dibër.**
- **Sh. C., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme në DAR Dibër.**
- A. K., me detyrë Specialist i Sektorit të Kurikulës dhe Cilësisë në DAR Dibër.
- S. B., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës në DAR Dibër.

**Përsa më lart, konstatohet se shtetasit B. D. dhe Sh. C. kanë qënë pjesë e komisionit për vlerësimin e kërkesës për ndarjen e gjimnazit “Said Najdeni”, në dy drejtori, si dhe vendimmarrës për ndarjen e tyre, po ti referohemi Urdhërit Nr. 138, datë 22.10.2018. Gjithashtu, kanë qënë pjesë e Komisionit Disiplinor të ngritur për të shqyrtuar ecurinë disiplinore për M. M., lidhur me hapjen e shkollës “Said Najdeni” dhe disa shkollave të tjera. Në këtë kuptim dhe në analizë të informacionit të sipërcituar, konstatohet se pavarësisht faktit që nga ana e grupit të kontrollit të MASR është rekomanduar marrja e masave për personat përgjegjës, të cilët kanë vendosur, nëpërmjet urdhërit Nr. 138, datë 22.10.2018 “Për ndarjen e gjimnazit ‘Said Najdeni’ në dy drejtori dhe funksionimin e gjimnazit ‘Said Najdeni 2’ me 1 drejtor dhe dy nëndrejtorë”, ndaj shtetasve B. D. dhe Sh. C, nuk është marrë asnjë masë dhe ndaj tyre nuk është iniciuar asnjë ecuri disiplinore. Pavarësisht kësaj, edhe pse këta individ kanë qënë në të njëjtat kushte me M. M., ata janë bërë pjesë e komisioneve për të shqyrtuar shkeljet e saj, duke trajtuar kështu ankuesen në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme.**

Në vijim të procedurave të ristrukturimit, me shkresën Nr. 4980 prot., datë 08.05.2019, Komisioni i Ristrukturimit të MASR-së ka vendosur “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore”. Nëpërmjet kësaj shkrese janë njohur me përfundimin e marrëdhënieve të punës në shërbimin civil të gjithë punonjësit e DAR/ZA-ve. Referuar kësaj shkrese, duke filluar me numër rendor 55

deri në 64, janë të renditur punonjësit e DAR Dibër të cilëve u përfundojnë marrëdhëniet në shërbimin civil, ndër to edhe M. M. Me lirim nga shërbimi civil MASR, me anë të shkresës Nr. 5150/3 prot., datë 14.05.2019, përcjellë nga DAR Dibër me shkresën 840/3 prot., datë 17.05.2019, është bërë njoftimi i M. M.

Gjithashtu, nga dokumentacioni dhe provat e vëna në dispozicion, po në të njëjtën datë, pra me 17.05.2019, me shkresën Nr. 845 prot., datë 17.05.2019, Komisioni Disiplinor i DAR Dibër i ngritur për shqyrtimin e ecurisë disiplinore të ankueses, me Vendimin Nr. 18, datë 17.05.2019, ka pushuar së ekzistuari për shkak se nuk ka patur me legjitimitet, pasi anëtarët e saj kanë përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil. **Në këto kushte, nga ana e Komisionit Disiplinor nuk është marrë asnjë vendim përfundimtar apo masë disiplinore ndaj ankueses.**

Po ti referohemi urdhërave për emërimin e përkohshëm të punonjësve të Zyrës Vendore Arsimore Dibër (ish DAR Dibër, tani ZVA Dibër), rezulton se janë emëruar gjatë muajit Maj 2019, këta punonjës:

- Me urdhërin nr. 27, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, B. D. emërohet Drejtor i ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune.
- Me urdhërin nr. 349, datë 30.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, H. Xh., emërohet Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune.
- Me urdhërin nr. 29, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, N. N., emërohet Specialist Finance në ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune.
- Me urdhërin nr. 30, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, S. M., emërohet Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune.
- Me urdhërin nr. 31, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, S. Xh., emërohet Specialist i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune.
- Me urdhërin nr. 32, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, A. K., emërohet Specialist i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune.
- Me urdhërin nr. 33, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, S. M., emërohet Specialist i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune.
- Me urdhërin nr. 28, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, Sh. C., emërohet Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve në ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune. I liruar nga kjo detyrë me urdhër Nr. 348, datë 30.05.2019, për shkak të plotësisimit të kushteve për pension pleqërie.



- Me urdhërin nr. 34, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, A. C., emërohet Specialist i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit profesional në ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune. Me urdhërin Nr. 330, datë 22.05.2019, është shkarkuar nga kjo detyrë në ZVA Dibër dhe është emëruar në të njëjtin pozicion në ZVA Bulqizë.
- Me urdhërin nr. 31, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë”, S. Xh., emërohet Specialist i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit profesional në ZVA Dibër, deri në zhvillimin e procedurave të konkurimit për këtë pozicion pune.

Referuar ndryshimeve strukturore dhe riorganizimit të DAR/ZA-ve në kuadër të krijimit të DPAP, rezulton se:

- Me Urdhërin nr. 199, datë 01.12.2010 të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së DAR dhe ZA” është miratuar struktura dhe organika e DAR-eve dhe ZA-ve dhe numri gjithsej, 509 veta. **Referuar këtij urdhri DAR Dibër përbëhej nga 20 punonjës.**
- Me Vendimin nr. 99, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të DPAP” është krijuar DPAP, institucion i cili përfshin tërësinë e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për shërbim arsimor cilësor.
- Me Urdhërin nr. 234, datë 19.04.2019, të MASR, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar”, është përcaktuar struktura e ZVA-ve dhe organika e tyre sipas 4 Drejtorive Arsimore Rajonale. Sipas këtij urdhri, numri i punonjësve të ZVA-ve do të ishte 428 vetë. **Referuar këtij urdhëri ZVA Dibër do të kishte gjithsej 10 punonjës.**
- Referuar pikës 13, Kreu III, të VKM-së nr. 99/2019 përcaktohet se: “Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe nëpunësve të DPAP-së, në nivel qendror dhe rajonal, si dhe në njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurimit të hapur, mbi bazën e rregullave të miratuara me urdhër të ministrit”.
- Komisioni i Ristrukturimit i MASR me shkresën nr. 4980, datë 08.05.2019 “Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civil të DAR dhe ZA” ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për 344 punonjës të ish DAR/ZA-ve.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, lidhur me ristrukturimin e DAR/Za-ve, rezulton se të gjithë punonjësit që kanë punuar pranë këtyre strukturave, bazuar në procedurat e parashikuara në nenin 50 të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, dhe VKM nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”,

janë njoftuar për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil dhe për të gjithë punonjësit e këtyre strukturave, nga ana e MASR, janë ndjekur të njëjtat procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Në analizë të informacionit të administruar, konstatohet se në struktura e vjetër e DAR Dibër (atë të miratuar me Urdhrin nr. 199, datë 01.12.2010 të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së DAR dhe ZA*”), pavarësisht se përcaktonte numrin 20 të punonjësve, ishin të emëruar 17 punonjës, duke lënë vakant 3 pozicione të lira pune. Ndërsa në strukturën e re të ZVA Dibër (atë të miratuar me Urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019, të MASR, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar*”), numri i punonjësve u reduktua në 10.

Gjatë periudhës Maj 2019, ZVA Dibër, ka bërë emëtime të përkohshme në pozicionet e lira të punës, duke konfirmuar 7 (shtatë) nga punonjësit që ishin pjesë e strukturës së mëparshme dhe lënë vakant 3 pozicione. Ndërsa punonjësit e tjerë të cilëve u ishte shkurtuar pozicioni i punës, nuk u konfirmuan me strukturën e re. Në këtë kuptim, pavarësisht se për M. M. nuk ishte konstatuar asnjë shkelje apo masë disiplinore, ankuesja nuk është emëruar në asnjë pozicion. Në këto kushte, vërehet se ZVA Dibër nuk ka trajtuar ankuesen në të njëjtën mënyrë me punonjësit e tjerë të ish DAR Dibër edhe pse ndodhej në kushte të njëjta me ta, pavarësisht se pozicioni i Juristit është ende i lirë në strukturë.

Pak ditë pas debatit të zhvilluar mes saj dhe Ministres së MASR, më datë 30.04.2019, ankuesja është vënë në dijeni në rrugë zyrtare, se ndaj saj ka nisur procedim disiplinor dhe është marrë vendimi për pezullimin nga detyra. Më pas me shkresën Nr. 5150/3 prot., datë 14.05.2019, është vënë në dijeni vendimi për largimin nga shërbimi civil për shkak të ristrukurimit. Komisioneri konstaton se pas debatit me Ministrën e Arsimit, DPAP dhe ZVA Dibër janë përshkallëzuar masat ndaj ankueses deri në largimin nga shërbimi civil.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja, në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm.

**Për sa më lart, Komisioneri, konstaton se ajo është trajtuar në mënyrë të padrejtë nga MASR, DPAP dhe ZVA Dibër, si dhe se masat e marra për mosemërimin e përkohshëm në pozicionin e juristit të institucionit kanë vënë në pozita të disfavorshme ankuesen krahasuar me punonjësit e tjerë të ZVA Dibër.**

## B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2<sup>11</sup>, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e MASR, DPAP dhe ZVA Dibër për shkak se më datë 26.04.2019, ka kundërshtuar Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. B. Sh., lidhur me vendimin e mbylljes së Shkollës “Said Najdeni”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh<sup>12</sup>. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh<sup>13</sup>.

Në mungesë të një praktike kombëtare Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e

---

<sup>11</sup> “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

<sup>12</sup> Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me .....ose me çdo shkak tjetër.”

<sup>13</sup> Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

**Pretendimi i ankueses se shkak për diskriminimin e saj janë bërë “idetë dhe qëndrimet kritike”, kundrejtë Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të cilat janë bërë edhe publike në median visive, përbën shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.**

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.**

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e MASR, DPAP dhe ZVA Dibër, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të pretenduar nga ankuesja, sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>14</sup> dhe trajtimit të pafavorshëm të saj.

Referuar informacionit të administruar, më datë 26.04.2019, Ministria e MASR, ka zhvilluar një takim në shkollën “Said Najdeni”. Në këtë takim të mbajtur, rezultoi që ankuesja të ketë qënë prezent dhe ka kundërshtuar vendimin e MASR për bashkimin e gjimnazit “Said Najdeni 1” dhe “Said Najdeni 2”, duke e konsideruar atë si një vendim të padrejtë dhe në dëm të nxënësve të qytetit të Peshkopisë. Sipas informacionit të administruar, në përgjigje të ankueses, Ministrja është shprehur se nuk e di në cilin univers mund të ndodhë që të protestojë punonjësi i Ministrisë kundër Ministrisë. Më pas, Ministrja është larguar, ndërsa ankuesja ka vijuar të shprehet mbi problematikën.

Katër ditë pas debatit, të zhvilluar mes ankueses dhe Ministres së MASR, ndaj ankueses ka nisur ecuria disiplinore, për një fakt për të cilin përgjegjës ishin edhe punonjës të tjerë DAR Dibër të

---

<sup>14</sup> Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

cilët kishin firmosur Urdhërin Nr. 138, datë 22.10.2018 “Për ndarjen e gjimnazit ‘Said Najdeni’ në dy drejtori dhe funksionimin e gjimnazit ‘Said Najdeni 2’ me 1 drejtor dhe dy nëndrejtorë”, ndaj të cilëve nuk u ndërmor asnjë veprim nga ana strukturave të MASR, DPAP apo ZVA Dibër, madje një prej tyre u emërua në pozicionin e Drejtorit të DAR Dibër e më pas në ZVA Dibër.

Për faktet që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se : *“Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim ”*, nuk lind nevoja për verifikim.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë përsa i takon mosemërimin të përkohshëm në pozicionin e Juristes së ZVA Dibër dhe fillimit të ecurisë disiplinore të nisur ndaj saj. Në këtë kuptim, trajtimi i pabarabartë ka nisur që me nisjen e ecurisë disiplinore, për të cilën nuk pati asnjë vendim përfundimtar për shkeljet për të cilat ishte akuzuar, dhe ka përfunduar me mosemërimin e saj njëloj si punonjësit e tjerë. Përsa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke parë në vijim veprimet e ndërmarra nga institucionet në varësi të MASR-së, si dhe mënyrën e reagimit të Ministres së MASR-së kundrejtë ankuses, krijon dyshimin e arsyeshem që kemi të bëjmë me diskriminim në formën e *“udhëzimit për të diskriminuar”*, parashikuar<sup>15</sup> në nenin 3, pika 6 e ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: ku citohet se: *“Udhëzim për të diskriminuar’ është një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.”*

Krahas kësaj, të gjitha direktivat për mosdiskriminimin thonë se “udhëzimi për diskriminim” çmohet të përbëjë “diskriminim”<sup>16</sup>.

*“Udhëzim për të diskriminuar”* si formë diskriminimi është trajtuar edhe nga GJEDNJ. Në çështjen *Bączkowski* dhe të tjerët kundër Polonisë (*Bączkowski and others v. Poland*), kryetari i Bashkisë së Varshavës bëri deklaratat publike me natyrë homofobike ku thoshte se do të refuzonte lejin e një marshimi për rritjen e ndërgjegjësimit për diskriminimin për shkak të orientimit seksual.<sup>17</sup> Kur vendimi ishte përpara organit administrativ përkatës, leja u refuzua për arsye të tjera, të tilla si nevoja për parandalimin e përplasjeve ndërmjet demonstruesve.

<sup>15</sup> “Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim ose kërkesë, bazuar në marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

<sup>16</sup> Neni 2(4), Direktiva për Barazinë në Punësim; Neni 4(1), Direktiva e trajtimit të Barabartë Gjinor në lidhje me aksesin dhe ofrimin e Mallrave dhe Shërbimeve; Neni 2(2)(b), Direktiva për Barazinë Gjinore (e rishikuar); Neni 2(4), Direktiva për Barazinë Raciale.

<sup>17</sup> [https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook\\_non\\_discr\\_law\\_SQL.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_law_SQL.pdf) fq.27

Në këtë rast, GJEDNJ konsideron se në vlerësimin e çështjes nuk mund të mos pranojë mendimet e forta personale të shprehura publikisht nga kryetari i bashkisë për çështje që lidhen drejtpërdrejtë me vendimet në lidhje me ushtrimin e lirisë së tubimit. Ajo vëren se vendimet në fjalë u morën nga autoritetet komunale që vepronin në emër të kryetarit pasi ai i bëri të njohur opinionet e tij në lidhje me ushtrimin e lirisë së tubimit dhe "*propagandës për homoseksualitetin*"<sup>18</sup>.

Sipas GJEDNJ, mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme që mendimet e kryetarit të bashkisë së Varshavës mund të kenë ndikuar në procesin e vendimmarrjes dhe si pasojë të shkelnin në mënyrë diskriminuese të drejtën e aplikantëve për lirinë e mbledhjes dhe kjo përbënte një shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 11, për shkak të orientimit seksual.

Në këtë kuptim, sipas vlerësimit të GJEDNJ "*udhëzimi për diskriminim*", nuk kufizohet thjeshtë me udhëzimet që janë detyruese në natyrë, por zgjerohet duke përfshirë situata ku ekziston një preferencë e shprehur në mënyrë direkte apo indirekte ose një inkurajim për të trajtuar individët në mënyrë më pak të favorshme.

Raste të tjera ku gjykatat kanë vlerësuar si diskriminim në formën e "*udhëzimit për të diskriminuar*" gjejmë si në praktikën e GJEDNJ, ashtu edhe te gjykatave vendase (kombëtare)<sup>1920</sup>.

Në VKM nr. 99 datë 27.02.2019 "*Për krijimin, mënyren e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", kap 1/2 parashikohet: *DPAP është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve parauniversitare, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për shërbim arsimor cilësor.*

Në rregulloren e MASR "*Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*" nr. 4699/1 prot, dt. 30.04.2019, neni 4 d/e citohet:

a)...

d) MASR përfaqësohet në nivel rajonal nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar të cilat janë në varësi administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

e) ZVAP-të funksionojnë si njësi të ofrimit direkt të shërbimeve dhe janë në varësi administrative të DRAP-ve.

<sup>18</sup> <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-80464%22%5D%7D> paragrafi100

<sup>19</sup> Marrë nga *Handbook on European Non-Discrimination Law*, faqe. 34. I referohet vendimit të Gjykatës Rajonale të Sofies Nr. 164 për çështjen civile Nr. 2860/2006, 21.06. 2006.

<sup>20</sup> Marrë nga *Handbook on European Non-Discrimination Law*, faqe. 34. I referohet vendimit të Gjykatës Rajonale të Sofies Nr. 164 për çështjen civile Nr. 2860/2006, 21.06. 2006.



Në analogji dhe në analizë të fakteve dhe provave Komisioneri vëren se veprimet e DPAP dhe ZVA Dibër, si institucione varësie të MASR, kundrejt ankueses, kanë ardhur menjëherë pas ngjarjes së ndodhur me ministren e MASR. Këto masa jo vetëm që u përshkallëzuan deri në largimin nga shërbimi civil të saj, por duhet të theksohet fakti që u ndërmoren vetëm ndaj ankueses dhe jo ndaj punonjësve të tjerë të cilët kishin qenë në kushte të ngjashme me të.

Bazuar sa më sipër, Komisioneri gjykon se ngjarja e ndodhur mes ankueses dhe ministres së MASR, e cila u bë edhe publike në media, ka ndikuar në veprimet e institucioneve arsimore vartëse të MASR, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrës Vendore Arsimore Dibër.

**Nga ana e MASR, DPAP dhe ZVA Dibër nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se procedurat e ndjekura për ecurinë disiplinore dhe mosemërimin e përkohshëm në pozicionin e Juristes, kishin ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.**

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë *“në gëzimin e të drejtave dhe lirive”* të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të

madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.<sup>21</sup>

Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës<sup>22</sup> “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Në kuptim të kësaj Konvente termi “*diskriminim*” përfshin: a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare ose origjinën sociale, që ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit, b) çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose profesionit, që mund të specifikohet nga një anëtar i interesuar, pasi të ketë konsultuar organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, si dhe organizma të tjerë të përshtatshëm.

Njëkohësisht, eliminimi i diskriminimit u ripohua si një kriter i pandarë i çdo politike të ILO-s<sup>23</sup> që prej adoptimit në vitin 1998 të “*Deklaratës së ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë*”. Kjo Deklaratë përcakton se të gjitha të drejtat themelore të njeriut duke përfshirë edhe eliminimin e diskriminimit përsa i përket punësimit dhe profesionit janë shumë të domosdoshme për mandatin e ILO-s. Në Deklaratë citohet se anëtarësia në Organizatë nga një shtet krijon në vetvete një detyrim për të promovuar këto të drejta edhe sikur shteti të mos ketë ratifikuar Konventat Themelore që parashtrajnë këto kritere.

Karta Sociale Europiane<sup>24</sup> parashikon si detyrim të të gjithë vendeve nënshkruese përmbushjen dhe zbatimin e disa parimeve. Në pjesën e parë të kësaj Karte parashikohet: “*Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive: Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht*”.

Në Kreun I, pika 1 e VKM-së nr. 99, datë 27.02.2019 ‘*Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore rajonale dhe Zyrat Arsimore*’, përcaktohet: “*Krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (në vijim, DPAP), si person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit*

<sup>21</sup> [https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook\\_non\\_discr\\_iaw\\_SQL.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_iaw_SQL.pdf), faqet 47 dhe 49

<sup>22</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

<sup>23</sup> International Labor Organization (Organizata Botërore e Punës)

<sup>24</sup> Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

*përgjegjës për arsimin (në vijim, ministri), me seli në Tiranë. DPAP-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme”.*

Në Kreun II, të VKM-së nr. 99, datë 27.02.2019 ‘Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Arsimore rajonale dhe Zyrat Arsimore’, parashikohet se: “II. Përgjegjësitë Funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, DPAP-ja ka këto përgjegjësi: 1. Të ofrojë shërbim cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit. 2. Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. 3. Të koordinojë administrimin e burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar publik, sipas legjislacionit në fuqi...”

Referuar barrës së proves sikurse është cituar dhe më lart në vendim, MASR, DPAP dhe ZVA Dibër, si subjekte nga të cilat është pretenduar diskriminimi, duhet të provonin se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe më pak të favorshme, për shkakun e pretenduar prej saj.

Të provosh një çështje diskriminimi është e vështirë, pasi autorët e diskriminimit nuk deklarojnë se ata trajtojnë dikë në mënyrë më pak të favorshme se të tjerët, lidhur me një shkak të caktuar. Parimi i ndarjes së barrës së provës është shumë i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - “*praesumptio iuris tantum*”.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesja duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur i pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “ *të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara”.*<sup>25</sup>

---

<sup>25</sup> GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

Në nenin 5 të ligjit nr. 152/2013 ‘Për nëpunësin civil’, i ndryshuar, parashikohet se: *“Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil.”*

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10 221/2010 parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Ligji nr. 10 221/2010 “Per Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfutimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Gjithashtu, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka mbajtur të njëjtën frymë në Vendimin Nr. 102, datë 18.10.2013, Vendimin nr. 113, datë 26.08.2019, ku ka konstatuar diskriminimin e shtetasit V. H., si dhe në Vendimin Nr. 165, datë 13.11.2019, ku ka konstatuar diskriminimin e shtetases E. D., për çdo shkak tjetër.

**Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e MASR, DPAP dhe DAR/ZVA Dibër nuk u vunë në dispozicion prova dhe fakte për të provuar se veprimet e ndërmarra nga ana e tyre për nisjen e procedurës disiplinore dhe mos emërimin e përkohshëm në pozicionin e Juristes së ZVA Dibër kanë qënë të ligjshme dhe proporcionale.**

**Në përfundim, Komisioneri vlerëson se praktika, e ndjekur nga ana e MASR, DPAP dhe DAR/ZVA Dibër, e ka vënë ankuesen në kushte të pafavorshme, në raport me persona të tjerë të cilët ndodhen në situatë të njëjtë përsa i përket nisjes së procedurës disiplinore dhe**

në kushte të ndryshme me të, për shkak se ka kundërshtuar Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. B. Sh., lidhur me vendimin e mbylljes së Shkollës “Said Najdeni”, në takimin e mbajtur me datë 26.04.2019. Në vijim të arsyetimit dhe mbështetur në provat e administruara, Komisioneri krijon bindjen se e gjithë situata diskriminuese ndaj ankueses ka nisur menjëherë pasi ka kundërshtuar Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. B. Sh., lidhur me vendimin e mbylljes së Shkollës “Said Najdeni”, në takimin e mbajtur me datë 26.04.2019.

Në kushtet kur, nga ana e MASR, DPAP dhe DAR/ZVA Dibër nuk u arrit të provohej që procedura e ndjekur për nisjen e procedimit disiplinor dhe mosemërimi në pozicionin e Juristes, ndjek një qëllim të ligjshëm, si dhe veprimet e kryera janë të arsyeshme dhe proporcionale, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e MASR, DPAP dhe DAR/ZVA Dibër, pikërisht për shkakun e pretenduar prej saj, të bërë publik edhe në media<sup>26</sup>, kundërshtimi i Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lidhur me vendimin e mbylljes së Shkollës “Said Najdeni”, në takimin e mbajtur me datë 26.04.2019.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e “udhëzimit për të diskriminuar” të shtetases M. M., nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për shkak të kundërshtimit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lidhur me vendimin e mbylljes së Shkollës “Said Najdeni”, në takimin e mbajtur me datë 26.04.2019.
2. Konstatimin e diskriminimit në formën e “diskriminimit të drejtëpërdrejtë” të shtetases M. M., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrës Vendore të Arsimit Dibër, për shkak të kundërshtimit të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lidhur me vendimin e mbylljes së Shkollës “Said Najdeni”, në takimin e mbajtur me datë 26.04.2019.

---

<sup>26</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=s9HKsirbhSo>

3. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa nga ana e strukturave të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrës Vendore të Arsimore Dibër, për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me shtetasen M. M.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Zyra Vendore Arsimore Dibër, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)